

KONTRATË
PËR SHIT – BLERJEN E KUOTAVE

Sot, më 28/04/2023 (dymijë e njëzetë e tre), shitësi dhe blerësi, kanë vendosur për përpilimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje të kuotave, me të dhënat më poshtë:

SHITËSI: **Shoqëria 51N4E bvba**, përfaqësuar nga Z. Anrys Johan Jozef J i datëlindjes 06.05.1974, lindur në Belgjikë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me Numër Personal 592-7969146-95,

dhe

BLERËSI: **Gent Agolli**, i datëlindjes 17.05.1964, lindur dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 035003483 dhe Numër Personal G40517115C.

BAZA LIGJORE

- 1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

Neni 1.

PERSHKRIMI I OBJEKTIT

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotës që **Shoqëria 51N4E bvba** zotëron në kapitalin e shoqërisë të së drejtës shqiptare “i RI ” SH.P.K. me nr. NIPT: **L71726018M** dhe blerja e saj nga ana e blerësit **Gent Agolli**.

Neni 2.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

2.1. Shoqëria “i RI ” SH.P.K. është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit datë 26/05/2017 me numër identifikimi NIPT L71726018M dhe ka si ortakë të saj:

- **Shoqëria 51N4E bvba**, përfaqësuar nga Z. Anrys Johan Jozef J, mbajtës i Kartës së Identitetit me Numër Personal 592-7969146-95, zotërues i 50% të kuotave të shoqërisë

- **Z. Gent Agolli, i biri i Hysen, shtetas shqiptar, i datëlindjes 17.05.1964, lindur dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me Numër Personal G40517115C, zotërues i 50% të kuotave të shoqërisë**

Palët e kësaj kontrate të shitjes së kuotave kanë rënë dakord sa më poshtë:

Shitjen e 1 (një) kuote me përqindje 50% të kapitalit të shoqërisë "I RI" Shpk në zotërim të Shoqërisë Shoqëria 51N4E bvba, tek blerësi Z. Gent Agolli

Çmimi i shit blerjes së kuotave për të cilën palët kanë rënë dakort do të jetë 2,950,000 Lek,

2.2. Me vendimin e datës 27 Prill 2023 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "i RI" SH.P.K. (Bashkëngjitur me këtë kontratë) është aprovuar shitja e kuotës që **Shoqëria 51N4E bvba zotëron** në këtë shoqëri, në favor të blerësit ortakut tjetër të shoqërisë **Z. Gent Agolli**.

2.3. Shitja e kuotës në favor të z. **Z. Gent Agolli** sjell humbjen e të drejtës së pronësisë mbi këtë kuotë nga ana e ortakut **Shoqëria 51N4E bvba**, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, të miratuar me vendim e asamblesë së ortakëve më të datës 27 Prill 2023.

2.4. Shitësi **Shoqëria 51N4E bvba** është plotësisht dakord të shesi me vullnetin e saj të plotë e të lirë kuotën në masën totale prej 50% të kapitalit të shoqërisë "i RI" SH.P.K. Kjo shitje e kuotave, mbi bazën e kësaj kontrate do shkojë në favor të Blerësit ortakut tjetër të shoqërisë **Z. Gent Agolli**.

2.5. Blerësi, **Z. Gent Agolli** bie dakord të blejë me vullnet të plotë e të lirë kuotën në masën 50% të kapitalit duke ja shtuar këtë kuotës që ai zotëron në kapital dhe duke fituar pronësinë e tërësisë së kapitalit prej 100%, njëkohësisht duke marrë cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "i RI" Shpk.

Neni 3.

KALIMI I TITULLIT TË PRONËSISË

3.1. Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, shitësi humbet pronësinë e kuotës që zotëron në shoqërinë "i RI" SH.P.K., duke mos patur më në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë kuotë. Ndërsa blerësi bëhet pronar i kuotës së shitur, në gjendjen në të cilën aktualisht rezulton nga librat e shoqërisë. Blerësi deklaron që është në dijeni për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga transferimi i pronësisë së kuotës dhe që i pranon, në gjendjen që janë tani, pa patur asnjë pretendim në lidhje me to, as sot e as në të ardhmen.



3.2. Shoqëria e regjistron kalimin e kuotës sipas Nenit 43 të Ligjit “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

3.3. Shoqëria “i RI” SH.P.K., mbas realizimit për shit-blerje kuote, në bazë të kësaj kontrate, do të ketë si ortak:

1. **Z. Gent Agolli**, zotërues i një kuote në masën 100% të kapitalit të shoqërisë;

Neni 4.

VLERA E SHITJES SË KUOTAVE

4.1. Çmimi i shitjes së kuotës nga ana e **Shoqëria 51N4E bvba**, në bazë të kësaj kontrate do të jetë në vlerën 2,950,000 Lek.

Neni 5.

GARANCITË

Shitësi garanton blerësin që:

- a. Ka pronësi të plotë mbi kuotën që shet përmes kësaj kontrate;
- b. Kuota është e lirë nga çdo e drejtë reale dhe garancie dhe nga çdo pretendim nga ana e palëve të treta;
- c. Ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat për të shitur kuotën në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

Neni 6.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

6.1. Kontrata përpilohet në 3 kopje të njëjta në gjuhën shqipe, nga të cilat palët mbajnë një kopje secili, një kopje depozitohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

PALËT

SHITËSI

51N4E bvba

Anrys Johan Jozef J

Anon ANRYS

51N4E

BLERËSI

Gent Agolli

GENT AGOLLI

iRI